INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS

RAPORT STATISTIKOR PËR PERIUDHËN 2007 - 2010

HYRJE

Inspektorati Policor i Kosovës është themeluar në bazë të rregullores së UNMIK-ut 2005/54 dhe ka funksionuar në bazë të Urdhëresës Administrative 2006/09 deri me hyrjen në fuqi të ligjit.
Me 1 korrik 2008 ka hyrë në fuqi të Ligjit mbi Inspektoratin Policor të Kosovës, dhe IPK-ja ka vazhduar të funksionoj në bazë të këtij ligji dhe akteve nënligjore që janë nxjerrur me qëllim të zbatimit të këtij ligji deri me nxjerrjen e ligjit të ri. Inspektorati Policor i Kosovës (IPK), tani funksionon bazuar në Ligjin e ri **Nr. 03/L-231** i cili ka hyrë në fuqi më 1 Dhjetor 2010.
IPK-ja, është e frymëzuar dhe kërkon që të vërteton pajtueshmërinë e policisë me Kodin Evropian të Etikës Policore si një kornizë e standardeve për kryerjen e detyrave policore në mënyrë demokratike.

Agjensioni kombinon dy funksione primare në ndjekje të parimeve të përgjegjësisë dhe transparencës - shtyllat e policisë demokratike:

- Parandalimi, zbulimi, dokumentimi dhe hetimi i veprave penale të kryera nga punonjësit e Policisë, pa dallim grade dhe pozite gjatë ushtrimit së detyrës ose jashtë saj, përfshirë edhe hetimet mbi incidentet e profilit të lartë disiplinor si dhe hetimin disiplinor të zyrtarëve policor me gradën më të lartë të nivelit të lartë të menaxhimit dhe zyrtarëve të lartë të nivelit ekzekutiv.

- Inspektimi i strukturave dhe funksioneve të Policisë së Kosovës (PK) për të siguruar llogaridhënie,efektivitet dhe efikasitet në zbatueshmërinë e ligjeve, akteve nënligjore dhe procedurave standarde të operimit në fuqi.

IPK-ja, duke ushtruar autorizimet e veta ligjore, aktivisht do të jetë kontribuese e arritjes së këtyre tri qëllimeve:

Efektshmërinë: duke u siguruar që qëllimet e PK-së janë arritur;

Pajtueshmërinë: duke u siguruar që qëllimet e PK-së janë arritur në pajtueshmëri të plotë me ligjet e aplikuara dhe standardet evropiane;

Zotësinë: duke u siguruar që qëllimet e PK-së janë arritur në mënyrën më fitimprurëse, duke ua bërë të ditur punën e policëve taksapaguesve të Kosovës.

DEPARTAMENTI I INSPEKTIMIT

Departamenti i Inspektimit ka filluar aktivitetin e saj në korrik të vitit 2006, kur edhe është krijuar Inspektorati Policor i Kosovës. Ky departament ka filluar punën në fillim si degë e vetme e IPK-së deri në fillimin e punës edhe të Departamentit të Hetimeve si pjesë integrale e IPK-së. Departamenti i Inspektimit, roli i të cilit është që të zhvilloj inspektime në Policinë e Republikës së Kosovës, të raportojë mbi punën dhe efikasitetin në arritjen e qëllimeve të menaxhmentit të saj, si dhe të japë rekomandime në dobi të efikasitetit, efektivitetit dhe pajtueshmërisë së punës policore me ligjet në fuqi.

Departamenti i Inspektimit kryen :

1. Inspektime të zakonshme dhe

2. Inspektime të jashtëzakonshme.

Inspektimet e zakonshme përfshihen në Planin Vjetor të Inspektimeve, ndërsa Inspektimet e jashtëzakonshme autorizohen nga Kryeshefi Ekzekutiv dhe janë të paplanifikuara më pare, organizohen varësisht nga nevoja.

- INSPEKTIMET E ZAKONSHME:

Gjatë vitit 2006

1. Menaxhimi i Trafikut rrugor (01/korrik 2006);
2. Menaxhimi i Parkut të automjeteve (02/ shtator 2006);
3. Menaxhimi i objekteve (03/tetor 2006);
4. Menaxhimi i Qendrave të ndalimit dhe arrestimit (04/nëntor 2006);
5. Menaxhimi i Burimeve njerëzore (05/dhjetor 2006);
6. Menaxhimi i Hetimit dhe detektimit të krimit (06/dhjetor 2006).

Gjatë vitit 2007

1. Menaxhimi i armëve të zjarrit (01/janar 2007);
2. Menaxhimi i ankesave dhe disiplinës (02/prill 2007);
3. Menaxhimi i buxhetit dhe financave (03/maj 2007);
4. Menaxhimi i zhvillimit të karrierës (04/qershor 2007);
5. Menaxhimi i Policisë kufitare (05/ gusht 2007);
6. Menaxhimi i Trafikut rrugor (06/tetor 2007);
7. Menaxhimi i Parkut të automjeteve (07/ tetor 2007);

8. Menaxhimi i objekteve (08/tetor 2007);
9. Menaxhimi i Qendrave të ndalimit dhe arrestimit (09/tetor 2007);
10. Menaxhimi i Burimeve njerëzore (10/nëntor 2007);
11. Menaxhimi i Hetimit dhe zbulimit të krimit (11/dhjetor 2007).

Gjatë vitit 2008

1. Menaxhimi i armëve të zjarrit (01/janar 2008);
2. Menaxhimi i Buxhetit dhe Financave dhe Prokurimit (02/mars 2008);
3. Menaxhimi i Planeve Policore në nivel lokal (03/Prill 2008);
4. Menaxhimi i Trajnimeve (04/maj 2008);
5. Planifikimi për reagim policor në situata emergjente (05/korrik 2008);
6. Menaxhimi i Policisë kufitare (06/tetor 2008);
7. Menaxhimi i Trafikut rrugor (07/nëntor 2008);
8. Menaxhimi i hetimit të krimit të organizuar (08/dhjetor 2008).

Gjatë vitit 2009

1. Menaxhimi i Qendrave të ndalimit dhe arrestimit (01/qershor 2009);
2. Menaxhimi i armëve të zjarrit dhe municionit (02/korrik 2009);
3. Menaxhimi i Burimeve njerëzore (03/gusht 2009);
4. Menaxhimi i ankesave dhe disiplinës (04/shtator 2009);
5. Menaxhimi i Parkut të automjeteve (05/ dhjetor 2009);
6. Menaxhimi i Hetimit dhe zbulimit të krimit (06/dhjetor 2009);
7. Menaxhimi i Objekteve (07/dhjetor 2009);

Gjatë vitit 2010

1. Menaxhimi i trafikut dhe sigurisë në rrugë (01/qershor 2010);
2. Menaxhimi i Trajnimeve (02/gusht 2010);
3. Menaxhimi i dosjeve Kriminale (03/dhjetor 2010);
4. Menaxhimi i dosjeve dhe bazës së të dhënave ne Njësinë e hetimeve të brendshme (04/dhjetor 2010);

- INSPEKTIMET E JASHTËZAKONSHME:

Gjatë vitit 2007

1. Shqyrtimi i sjelljes së Policisë gjatë trazirave qytetare, të 10 shkurtit 2007 (01/mars 2007);
2. Inspektimi i Policisë në lidhje me pajtueshmërinë e nenit 7 të rregullores 2005/54 (02/prill 2007);
3. Inspektimi i policisë lidhur me menaxhimin e laboratorit të krimteknikës (03/korrik 2007);

4. Raport mbi hetimet e UNMIK-ut lidhur me protestat e 10 shkurtit 2007.

Gjatë vitit 2008

1. Siguria e Ndërtesave dhe Automjeteve të Policisë (01/janar 2008);
2. Menaxhimi i situatës nga ana e Policisë gjatë festës së Pavarësisë (02/shkurt 2008);
3. Përdorimi i automjeteve në thirrje (03/prill 2008);
4. Menaxhimi i hetimit të krimit në Regjionin e Ferizajt (04/korrik 2008);
5. Menaxhimi i situatës nga zyrtaret policor me rastin e protestave për largimin e materieve te rrezikshme (05/gusht 2008);
6. Inspektimi i Komandës Regjionale të Mitrovicës lidhur me përfshirjen e mundshme të zyrtarëve policor në kontrabandën me mallra (06/shtator 2008);
7. Inspektimi i patrullave policore gjate natës (07/tetor 2008).

Gjatë vitit 2009

1. Ligjshmëria e procesit te edukimit dhe trajnimit të zyrtarëve policor në Universitetin e Sarajevës (01/ mars 2009);
2. Përdorimi i automjeteve policore jashtë orarit zyrtar te punës nga ana e zyrtarëve policor (02/prill 2009);
3. Menaxhimi i Dhomave te Dëshmive nga Policia e Kosovës (03/qershor 2009);
4. Menaxhimi i situatës nga Policia e Kosovës gjatë protestave të qytetarëve Serb të fshatrave Korminjan dhe Ranillug (04/gusht 2009);
5. Menaxhimi i situatës nga Policia e Kosovës me rastin e dëmtimit te automjeteve te EULEX-it (05/shtator 2009);
6. Menaxhimi i situatës së sigurisë nga Policia e Kosovës gjate procesit te zgjedhjeve komunale (06/dhjetor 2009).

Gjatë vitit 2010

1. Menaxhimi i situatës nga PK gjate operacionit për arrestimin e liderit te Vetëvendosjes (01/shtator 2010);
2. Vlerësimi i përgjithshëm i performancës menaxheriale të stacioneve policore (02/nëntor 2010);
3. Kryerja e detyrave nga Policia e Kosovës gjate asistimit për mbylljen e lokaleve te natës (03/nëntor 2010);
4. Vlerësimi i nivelit te masave te sigurisë ne stacione policore për personat e paautorizuar (04/dhjetor 2010).

Inspektorati Policor i Kosovës gjatë kësaj periudhe të punës ka kryer gjithsejtë 36 inspektime të rregullta, si dhe 21 inspektime të jashtëzakonshme.

DEPARTAMENTI I HETIMEVE

Objekt i veprimtarisë hetimore të IPK-së është parandalimi, zbulimi, dokumentimi dhe hetimi i veprave penale të kryera nga punonjësit e Policisë, pa dallim grade dhe pozite gjatë ushtrimit së detyrës ose jashtë saj, përfshirë edhe hetimet mbi incidentet e profilit të lartë disiplinor si dhe hetimin disiplinor të zyrtarëve policor me gradën më të lartë të nivelit të lartë të menaxhimit dhe zyrtarëve të lartë të nivelit ekzekutiv.

Hetimi i incidenteve disiplinore të profilit të lartë, ku përfshihen të gjithë punonjësit e Policisë së Kosovës, siç është përcaktuar ne nenin 4, paragrafi 1. nën-paragrafi 1.11 të ligjit të IPK-së; Hetimi i të gjitha shkeljeve disiplinore të supozuara të zyrtarëve policor me gradën më të lartë të nivelit të lartë të menaxhimit dhe zyrtarëve policor të nivelit të lartë ekzekutiv;

Pranimi i të gjitha ankesave të qytetarëve si dhe shqyrtimi dhe përcaktimi se cilat nga ankesat hetohen nga IPK dhe cilat do t'i referohen Policisë së Kosovës apo institucioneve përgjegjëse;

Hetimi i integritetit ka për qëllim të zhvillojë kapacitetin proaktiv në ruajtjen e etikës dhe integritetit në kuadër të standardeve të larta profesionale brenda Policisë duke kontribuar në përpjekjet mbi kontrollin e korrupsionit, duke rritur cilësinë e shërbimit dhe rritjen e besimit të publikut ndaj Policisë.

Hetuesit e IPK-së gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, kanë autorizimet policore dhe i ushtrojnë ato në përputhje me Kushtetutën, Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale, me këtë ligj si dhe me ligjet dhe aktet nënligjore tjera në fuqi.

Hetuesit e IPK-së kanë të drejtë të mbajnë dhe të përdorin armë si dhe forcën në përputhje me Ligjin për Policinë, ligjet përkatëse në fuqi dhe aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të tyre.

I. TE DHENA STATISTIKORE (RASTE TE PRANUARA) 2007-2010

Tabela 1.

Ankesat	tetor-dhjetor 2007	%	2008	%	2009	%	janar-dhjetor 2010	%
Ankesat e qytetarëve	122	48.8	789	38.9	782	46.33	590	49.8
Inicimi i hetimeve të brendshme	128	51.2	1235	61.1	906	53.67	595	50.2
Gjithsejtë	**250**	**100**	**2024**	**100**	**1688**	**100**	**1185**	**100**



Në tabelën nr.1, kemi dy kategori: ankesat e qytetarëve që nënkupton kur çdo qytetar ankohet ndaj ndonjë punonjësi të policisë së Republikës së Kosovës dhe kategoria e dytë, inicimi i hetimeve të brendshme që nënkupton kur iniciohet procedurë nga brenda policisë për ndonjë punonjës të policisë.

II. Statusi i rasteve (lëndëve) – 2008

Tabela 1.

Viti 2008		Numri	%
Dërguar në Njësinë e Hetimeve të Brendshme Policore		781	38.6
Të mbyllura	Ankesa të pa baza	323	15.9
	Të pushuara pas hetimit	168	8.3
Raste për KELDP	Rastet e kompletuara për KELDP	157	7.8
	Raste të punonjësve serb	325	16.1
Në proces	Nën hetime	130	6.4
	Të pezulluara	140	6.9
Gjithsejtë		2024	100

*** Rastet e punonjësve Serbë të policisë nuk u janë referuar KELDP-së fare edhe pse hetimet për ta janë kryer nga IPK-ja**

Në tabelën nr.1 paraqitet ecuria e statusit të rasteve disiplinore për vitin 2008 që nënkupton pranimin. Kategorizimin, hetimin dhe kompletimin e rasteve për KELDP.

III. Statusi i rasteve (lëndëve) – 2009

Tabela 1.

Viti 2009		Numri	%
Dërguar në Njësinë e Hetimeve të Brendshme Policore		677	40.11
Të mbyllura	Ankesa të pa baza	337	19.96
	Të pushuara pas hetimit	179	10.60
Raste për KELDP	Rastet e kompletuara për KELDP	139	8.23
Në proces	Nën hetime	141	8.35
	Të pezulluara	215	12.74
Gjithsejtë		1688	100

Në tabelën nr.1 paraqitet ecuria e statusit të rasteve disiplinore për vitin 2009 që nënkupton pranimin. Kategorizimin, hetimin dhe kompletimin e rasteve për KELDP.

IV. TE DHENA STATISTIKORE 2010

Tabela 1.

NUMRI TOTAL I LËNDËVE TË PRANUARA GJATË KËTIJ VITI	**1185**
Numri i lëndëve të cilat janë kthyer në Drejtorinë e Hetimeve të Brendshme si SHLD	**541**
Numri i lëndëve të pezulluara (të pezulluara vetëm nga lëndët e pranuara gjatë vitit 2010)	**106**
Numri i lëndëve të hedhura poshtë si të pabaza për të filluar hetimin (vetëm për lëndët e pranuara gjatë vitit 2010)	**257**
Numri i lëndëve që ka pushuar hetimi, si të paargumentuara (vetëm për lëndët e pranuara gjatë vitit 2010)	**158**
Numri i lëndëve të kompletuara për KELDP-në (vetëm nga lëndët e pranuara gjatë vitit 2010)	**100**
Numri i lëndëve që janë në proces	**23**

Në tabelën me nr. 4 është i paraqitur të i tërë procesi rreth rasteve të pranuara, kategorizimi i tyre, hetimi, kompletimi dhe lëndët që janë bartur në vitin 2011 të cilat janë në proces.

Tabela 2: Statistika e lëndëve të pranuara në periudhën janar-nëntor 2010

Muaji	Inicim i Brendshëm	%	Ankesa të qytetarëve	%	Institucion e tjera	%	Totali	%
JANAR	52	8.74%	36	6.24%	2	15.38%	**90**	**7.59%**
SHKURT	66	11.09%	35	6.06%	0		**101**	**8.52%**
MARS	60	10.08%	54	9.35%	0		**114**	**9.62%**
PRILL	33	5.54%	75	12.99%	0		**108**	**9.11%**
MAJ	59	9.91%	49	8.49%	0		**108**	**9.11%**
QERSHOR	71	11.93%	42	7.28%	1	7.69%	**114**	**9.62%**
KORRIK	33	5.54%	55	9.53%	5	38.46%	**93**	**7.85%**
GUSHT	74	12.43%	83	14.38%	2	15.38%	**159**	**13.41%**
SHTATOR	59	9.91%	41	7.10%	3	23.07%	**103**	**8.69%**
TETOR	43	7.22%	59	10.22%	0		**102**	**8.60%**
NËNTOR	45	7.56%	48	8.32%	0		**93**	**7.85%**
TOTAL:	**595**	**100 %**	**577**	**100 %**	**13**	**100 %**	**1185**	**100.0 %**

Tabela 3: Paraqitja tabelore e lëndëve në periudhën janar- nëntor 2010 **sipas kategorive**

KATEGORIA	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	TOTALI	%
Supozim për shkelje të rënda disiplinore	30	39	32	44	39	46	42	49	34	31	22	408	34.43%
Supozim për shkelje të lehta disiplinore	41	58	58	44	44	57	31	66	43	50	49	541	45.65%
Ankesa të pa baza	19	14	24	15	20	21	21	34	25	21	22	236	19.91%
TOTALI:	**90**	**101**	**114**	**108**	**108**	**114**	**93**	**159**	**103**	**102**	**93**	**1185**	**100.0%**

Tabela 4: Paraqitja tabelore e lëndëve në periudhën janar- nëntor 2010, **sipas statusit**

STATUSI I LËNDËS	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	TOTALI	%
Në proces	0	0	0	0	0	0	0	0	1	4	11	**16**	**1.35%**
Për KELDP	14	13	12	12	13	10	11	9	4	2	0	**100**	**8.43%**
Në DHB të policisë	41	58	58	44	44	57	31	66	43	50	49	**541**	**45.65%**
Të pezulluara	7	6	6	7	7	9	9	19	5	12	5	**92**	**7.7%**
Të pushuara	16	22	16	25	21	25	20	21	21	9	4	**200**	**16.87%**
Të pa baza	19	14	24	15	20	21	21	34	25	21	22	**236**	**19.91%**
Totali:	**90**	**101**	**114**	**108**	**108**	**114**	**93**	**159**	**103**	**102**	**93**	**1185**	**100.0%**

Tabela 5: Paraqitja tabelore e lëndëve në periudhën janar- nëntor 2010, **sipas akuzës**

Akuza / supozim për shkelje të rëndë disiplinore	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	TOTALI	%
Sjellje e rëndë diskredituese	8	4	9	14	8	7	12	7	9	3	4	**85**	**20.83%**
Shkelje e rëndë e autorizimit	4	8	4	2	5	12	8	12	3	2	3	**63**	**15.44%**
Mosbindje e rëndë	1	6	4	2	9	4	3	5	4	0	0	**38**	**9.31%**
Përdorim i tepërt i forcës	5	9	3	10	5	11	4	11	8	10	0	**76**	**18.62%**
Dëmtimi i rëndë i pasurisë së Policisë	2	3	2	2	0	2	0	3	1	1	0	**16**	**3.92%**
Veprimtaria penale	9	3	5	4	5	6	8	2	1	4	5	**52**	**12.74%**
Korrupsioni	0	0	1	3	0	1	1	1	0	0	0	**7**	**1.71%**
Përdorim i pavend i armes	1	2	0	2	7	1	2	5	4	3	0	**27**	**6.62%**
Zbulimi i pavend dhe i rëndë i informatave	0	1	1	1	0	1	1	0	1	0	0	**6**	**1.47%**
Përdorimi i alkoolit ose i substancave të tjera intoksikuese	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	1	**2**	**0.49%**
Keqpërdorimi dhe shfrytëzimi seksual i ndonjë personi	0	0	0	1	0	0	1	0	0	0	0	**2**	**0.49%**
Ngacmimi seksual gjatë shërbimit	0	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0	**1**	**0.28%**
Tjera	0	2	3	3	0	1	1	3	3	8	9	**33**	**8.08%**
Totali:	**30**	**39**	**32**	**44**	**39**	**46**	**42**	**49**	**34**	**31**	**22**	**408**	**100.0%**

Tabela 6: Paraqitja tabelore e lëndëve në periudhën janar-nëntor 2010, **sipas gradave**

Grada / supozim për shkelje të rëndë disiplinore	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	TOTALI	%
Polic	30	53	34	35	45	52	55	46	32	30	28	**440**	**75.21%**
Rreshter	5	5	4	5	3	8	8	4	5	4	1	**52**	**8.88%**
Toger	2	0	3	2	5	4	1	3	5	1	1	**27**	**4.61%**
Kapiten	0	1	3	4	1	0	0	0	0	2	1	**12**	**2.05%**
Major	0	1	0	0	0	1	2	0	0	0	0	**4**	**0.68%**
Nënkolonel	0	1	1	2	0	1	1	0	0	0	1	**7**	**1.19%**
Kolonel	0	0	0	0	0	2	0	0	0	0	0	**2**	**0.34%**
Staf civil	1	2	0	3	3	2	1	1	1	3	0	**17**	**2.90%**
O/S	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	**0**	**0%**
E panjohur	1	2	2	4	1	0	1	2	4	4	3	**24**	**4.10%**
Totali												**585**[1]	**100.0%**

Tabela 7: Paraqitja tabelore e lëndëve në periudhën janar- nëntor 2010, **sipas regjioneve**

Regjioni / supozim për shkelje të rëndë disiplinore	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	TOTALI	%
Prishtinë	10	21	15	13	15	25	21	26	16	9	13	**184**	**31.45%**
Prizren	8	2	5	12	9	4	8	5	8	4	6	**71**	**12.13%**
Pejë	1	1	3	7	13	4	7	3	9	5	4	**57**	**9.74%**
Gjilan	10	11	1	3	8	8	5	4	1	3	1	**55**	**9.40%**
Mitrovicë	6	17	10	6	7	11	12	7	9	10	1	**96**	**16.41%**
Ferizaj	2	6	3	0	3	7	2	5	0	7	0	**35**	**5.98%**
Policia Kufitare	1	5	8	6	2	9	13	6	0	0	6	**56**	**9.57%**
Të panjohura	1	2	2	8	1	2	1	0	4	6	4	**31**	**5.30%**
Totali												**585**	**100.0%**

[1] Numri i përgjithshëm i punonjësve të përfshirë në supozim për shkelje të rëndë disiplinore. (janë inicuar 408 raste, mirëpo ka raste kur ka qenë mundësia e përfshirjes së më shumë se një punonjës i PK-së në një rast të inicuar).

Tabela 8: Paraqitja tabelore e lëndëve në periudhën janar- nëntor 2010, sipas **gjinisë**

Gjinia / supozim për shkelje të rëndë disiplinore	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	TOTALI	%
Mashkull	34	58	45	45	54	63	64	55	41	38	30	**527**	**90.08%**
Femer	4	5	0	2	3	7	4	1	4	3	2	**35**	**5.98%**
E panjohur	1	2	2	8	1	0	1	0	2	3	3	**23**	**3.93%**
Totali												**585**	**100.0%**

Tabela 9: Paraqitja tabelore e lëndëve në periudhën janar- nëntor 2010, sipas **përkatësisë etnike**

Përkatësia etnike / supozim për shkelje të rëndë disiplinore	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	TOTALI	%
Shqiptar	7	50	39	40	49	47	54	47	44	35	49	**461**	**78.80%**
Serb	30	13	5	6	7	12	2	9	1	6	3	**94**	**16.06%**
Boshnjak	1	0	1	1	1	1	2	0	0	0	0	**7**	**1.19%**
E panjohur	1	2	2	8	1	0	1	0	2	3	3	**23**	**3.93%**
Totali												**585**	**100.0%**

Të dhënave statistikore të lëndëve të pranuara dhe të dërguara në DHB për muajin, **dhjetor 2010**

Muaji	Inicim i Brendshëm	Ankesa të qytetarëve	Institucionet tjera	Gjithësejt lëndë
DHJETOR	0	61	0	**61**
TOTAL:	**0**	**61**	**0**	**61**

Në tabelën e sipërme është e paraqitur gjendja e pranimit dhe procedimit të rasteve të pranuara nga Inspektorati Policor i Kosovës prej 1 deri më 31 dhjetor kur edhe ka hyrë në fuqi ligji i ri i IPK-së.

V. TE DHENAT STATISTIKORE (KELDP) 2007-2010

Tabela 1.

Numri i lëndëve të kompletuara për KELDP-në, që nga operacionalizimi i Departamentit të Hetimeve	**546**
Numri i lëndëve të cilat edhe pas kompletimit për KELDP, të cilat pas rishqyrtimit, me autorizim të Kryeshefit, nuk i janë referuar KELDP-së	**62**
Numri total i lëndëve të dërguara në KELDP	**416**
Numri total i lëndëve të kompletuara deri në këtë moment që presin për tu dërguar në KELDP	**68**

Në tabelën nr.1 paraqitet procesi i kompletimit të rasteve për KELDP-në që nga operacionalizimi i Departamentit të Hetimeve. Për rastet e kompletuara janë rekomanduar masa disiplinore.

VI. Historiku i masave disiplinore – 2007-2010

Sipas legjislacionit, rezultatet e rasteve të rënda disiplinore të hetuara nga IPK-ja arrihen si rrjedhojë e procedurës së mëposhtme:

1. IPK i raporton të gjeturat e saj në lidhje me rastin tek KELDP-ja dhe i rekomandon masën disiplinore;
2. KELDP pas mbajtjes së seancës dëgjimore/disiplinore rekomandon masën disiplinore ndaj punonjësve policorë tek Drejtori i Përgjithshëm (DP) i PK-së;
3. DP i PK-së shqipton masat disiplinore kundër punonjësve policorë duke marrë në konsideratë rekomandimet e dhëna nga KELDP;
4. Kundër vendimit të DP-së, punonjësit policorë kanë të drejtë ankese tek Ministri i MPB-së, i cili i shqyrton ato ankesa dhe jep vendimin përfundimtar administrativ.

Tabela 1.

Rekomandimet dhe vendimet	IPK	KELDP	DP i KP	Ministri	
				Të hedhura	Të ndryshuara
Ndërprerje e marrëdhënies së punës	128	123	96	42	3
Ulje e gradës	18	3	1	/	1
Largim nga pozita komanduese	3	/	/	/	/
Suspendim pa pagesë prej 30 – 60 ditë pune	183	63	44	17	8
Ndalesë në pagë prej 20 – 30% e pagës mujore bruto	126	116	74	10	3
Në proces të KELDP-së	/	99	/	/	/
Lirim nga fajësia	/	54	32	1	/
Gjithsejtë	**458**	**458**	**247**	**70**	**15**

- Gjer më 31 Dhjetor 2010, IPK-ja ka rekomanduar 458 masa disiplinore ndaj punonjësve të policisë ndaj të cilëve hetimi ka përfunduar i argumentuar.
- Nga rekomandimet mbi masat disiplinore, deri më tani nga Drejtori i Përgjithshëm (DP) i PK-së janë proceduar dhe shqiptuar masat ndëshkimore ndaj 247 punonjësve policorë (vendimet tjera janë në proces e sipër).
- 85 punonjës policorë kanë parashtruar ankesë ndaj këtyre vendimeve tek Ministri i Punëve të Brendshme, i cili i ka hedhur poshtë 70 sosh si ankesa të pabaza, ndërsa ka ndryshuar apo shfuqizuar vendimet e marra nga DP i PK-së për 15 raste.
- Gjer më 31 Dhjetor 2010 IPK ka përfunduar hetimet dhe ka kompletuar 546 raste të shkeljeve të rënda disiplinore. Për shkak se KELDP-ja ka filluar punën shumë më vonë se Departamenti i Hetimeve në IPK, ende nuk ka arritur t'i shqyrtojë të gjitha rastet e përgatitura.